



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT  
DHE KONTROLLIT TË PASURIVE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

### MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

**Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (ILDKP)** në mbështetje të ligjit nr.9049, date 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” nenit 17, pika “b”, mbledh të dhëna, kryen hetime dhe kërkime administrative rreth deklarimeve të personave që kanë detyrimin për deklarim, sipas këtij ligji, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative;

**Agjencia e Prokurimit Publik (APP)** në mbështetje të ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, neni 26 "Veprimet korruptive dhe konflikti i interesave" si dhe neni 65, shkronja "ç", duhet të marrë të gjitha masat për të shmangur dhe luftuar konfliktin e interesave në procesin e prokurimit publik.

Përsa më sipër, palët bien dakort të respektojnë qëllimin e këtij Memorandumi Bashkëpunimi si më poshtë:

#### **Neni 1 Qëllimi**

- Realizimi i bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet dy palëve në përshpejtimin e procedurave ligjore në rastet e hetimeve administrative dhe parandalimit të konfliktit të interesit në fushën e prokurimit publik të bizneseve të regjistruara si brenda ashtu dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

- Koordinimi dhe mbledhja e të dhënave të operatorëve ekonomikë, subjekte të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", që do t'i shërbejnë ILDKP-sw në drejtim të rritjes së kapaciteteve investiguese, në zbatim të ligjit Nr.9049, date 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të

disa nëpunësve publike dhe Ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

## **Neni 2 Objekti**

- Palët angazhohen për bashkëpunim konkret në realizim të qëllimit të këtij Memorandumi, në frymën e nenit 26 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Palët do të bashkëpunojnë në shkëmbimin e informacionit që disponojnë me qëllim evidentimin, parandalimin dhe shmangjen e konfliktit të interesave në administratën publike.
- Bazuar në kërkesat reciproke, palët përkatësisht do të shkëmbejnë çdo informacion të disponueshëm që mund të ketë të bëjë me investigimin për korrupsionin, krimin ekonomik me personat, kompanitë dhe/ose subjekte të tjera të përfshira.
- APP-ja angazhohet t’i krijojë akses ILDKP në të dhënat e saj elektronike nëpërmjet regjistrit të saj on-line ose me anë formave të tjera të mundshme elektronike.
- ILDKP-ja angazhohet nga ana e saj të vërë në dispozicion të APP-së çdo informacion apo të dhënë,të dalë nga verifikimi dhe kontrolli i deklaratave të interesave private të zyrtarëve-deklarues, që i shërben veprimtarisë institucionale të APP-së.
- ILDKP-ja angazhohet në ofrimin e ekspertizës ligjore për APP-në gjatë procedurave të hetimit administrativ, në trajtimin e rasteve të konfliktit të interesave.
- Në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjelltë institucional, ILDKP-ja dhe APP-ja angazhohen për përgatitjen e materialeve shpjegues mbi parandalimin e konfliktit të interesave në fushën e prokurimit publik.

## **Neni 3 Komunikimi**

Palët do të caktojnë person kontakti që do të jenë përgjegjës për zbatimin e Memorandumit. Në rastet e shmangies nga procedurat e përcaktuara në këtë Memorandum, palët do të merren vesh për procedura të pranueshme komunikimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **Neni 4 Ndryshime**

Memorandumi mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjelltë me shkrim të palëve.

**Neni 5**  
**Përfundimi i Memorandumit**

Memorandumi mund të përfundojë në çdo kohë. Përfundimi do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimit me shkrim nga Pala tjetër.

Deri në përfundimin e këtij Memorandumi, palët do t'u përmbahen termave dhe kushteve që rrjedhin nga ky Memorandum, përsa i përket informacionit dhe dokumentave të shkëmbyera përpara datës së përfundimit të tij.

**Neni 6**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga përfaqësuesit e palëve. Memorandumi, hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe dy të tjera në Agjencinë e Prokurimit Publik.

Ky Memorandum Bashkëpunimi u nënshkrua sot, në datë 13 Mars 2008.

**PËR INSPEKTORATIN E LARTË  
DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT  
TË PASURIVE**

**PËR AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK**

**INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM  
FATMIRA LASKA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
KLODIANA CANKJA**